




**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO**

**KOMUNA SHTIME**  
**OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME**

**Zyra e Kryetarit të Komunës**  
**Kancelarija Predsednika Opshtine/Mayor's Office**



Nr. 02/803

Datë: 01.12.2022

Në mbështetje të nenit 13, dhe nenit 17, shkronja (g) të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008), të nenit 37, paragrafi 2, nenit 56, paragrafi 1, nenit 77, paragrafi 1 dhe 2, si dhe nenit 91, paragrafi 1, pika 1.6 të Ligjit Nr. 04/L-027, për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera, në pajtim me nenin 54 të Statutit të Komunës së Shtimes 01 Nr. 06/1636, të datës: 03.09.2008, dhe me qëllim të qasjes së unifikuar të aktiviteteve të menaxhimit emergjent ndaj fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, Kryetari i Komunës, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**Për themelimin e Shtabit Lokal për Gatishmëri Emergjente**

- I. Themelohet Shtabi Lokal për Gatishmëri, Reagim dhe Menaxhim Emergjent ndaj Fatkeqësive Natyrore dhe Fatkeqësive Tjera.
- II. Anëtarët e Shtabit Emergjent të cekur si në pikën 1 të këtij vendimi, janë:
  1. Qemajl Aliu- Kryetar i Komunës, Kryesues i Shtabit
  2. Faruk Beqa- Nënkryetar i Komunës, zv. Kryesues i Shtabit,
  3. Bardhyl Rushiti- Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike, anëtar
  4. Lulzim Sahiti-Drejtor i Arsimit. Anëtar
  5. Kastriot Shabani-Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, anëtar
  6. Fatmir Limani- Komandant i Stacionit të Policisë së Kosovës-Shtime, anëtar
  7. BajramGashi- Komandant i Njesisë Profesionale për Zjarrfikje dhe Shpëtim, anëtar
  8. Pranvera Bajrami- Drejtoreshë e QKMF-së "Dr. Vezir Bajrami"-Shtime, anëtare
  9. Skënder Dauti- Përgjegjës i Zyrës për Mbrojtje dhe Shpëtim, anëtar
  10. Gezim Morina- Rreshter i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), anëtar
  11. Behadin Rexhepi- Klubit të Bizneseve ( sektori privat), anëtar
  12. Herolind Selmani-NPRM "Pastërtia" Shtime, anëtar
  13. Baki Rashiti-Kompanisë së Ujësjiellësit Rajonal "Prishtina"- Njësia në Shtime, anëtar
  14. Hysen Veseli-KEDS-it, Nëndistrikti në Shtime, anëtar
  15. Nazmi Shahini-Kryqit të Kuq Lokal-Dega në Shtime, anëtar.
- III. Përbërja e këtij Shtabi është dizajnuar për të mundësuar menaxhim dhe koordinim efikas dhe të efektshëm ndaj fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive.

- IV. Kjo përbërje siguron koordinim të përbashkët ndërveprues dhe ndërinstitucional: të reaguesve të parë, ndërmarrjeve publike, OJQ-ve, Kryqit të Kuq Lokal dhe sektorit privat.
- V. Ky Shtab ka mandat për planifikimin, organizimin, mobilizimin dhe aktivizimin e strukturave për mbrojtje dhe shpëtim, për të adresuar efektet e shpejta dhe të drejtpërdrejta, duke i përfshi veprimet e menjëhershme për ruajtjen e jetës së njerëzve, të mirave materiale dhe plotësimin e nevojave elementare njerëzore si dhe mirëmbajtjen e strukturës sociale të komunitetit të goditur.
- VI. Detyrat, rolet dhe përgjegjësitë e shatbit emergjent duhet të zbatohen në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-027, për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera;
- VII. Planin e Reagimit Kombëtar, dhejtor 2010, dhe
- VIII. Sistemin e Integruar të Menaxhimit të Emergjencave, maj 2010.
- IX. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës.
- X. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.

Vendimi iu dërgohet:

- Anëtarëve
- Arkivit të Komunës

Qemajl Aliti  
Kryetari i Komunës

